



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më __.02.2023

MBLEDHJA Nr. 07,
Datë 16.02.2023, ora 10:00
e Bordit të ERE-s

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Enjte, datë 16.02.2023, ora 10:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 07 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbal-it të mbledhjes së bordit të ERE-s datë 09.02.2023
2. Mbi çmimin e aplikueshëm për prodhuesit ekzistues me përparësi për vitin 2023, në zbatim të ndryshimeve të miratuara me VKM nr. 67, datë 8.2.2023
3. Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin janar 2023 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV dhe çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV për vitin 2023
4. Mbi amendimin e kontratës për shit blerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit ndërmjet OST sh.a. dhe KESH sh.a.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI